



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Organi Shqyrtues i Prokurimit
Telo Za Razmatranje Nabavke - Procurement Review Body



Rr. "Migjeni" (ish Banka e Ljublanës), Kati V, Prishtinë 10000, Republika e Kosovës
Tel: +383 (0)38 312 309 - Email: oshp@rks-gov.net

PSH. Nr. 969/23

Në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, Paneli shqyrtues në përbërje nga Vedat Poterqoi-Kryetar, Vjosa Gradinaj Mexhuani dhe Isa Hasani anëtar, pas shqyrtimit të ankesës së OE "Milenium Konstruktion Sh.P.K" . kundër Vendimit për dhënie të një kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit "Trajtimi i rrugëve me zhavor në fshatrat e Komunës së Prishtinës" me numër të prokurimit 616-22-11624-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – "Kuvendi i Komunës së Prishtinës", Kryetarja e Panelit Shqyrtues, Vjosa Gradinaj Mexhuani, me datën: 20/12/2023, mori këtë:

VENDIM

Hedhet si e palejuar, ankesa e OE "Milenium Konstruktion Sh.P.K". me nr. të protokollit 2023/0969, e datës 04/12/2023, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit "Trajtimi i rrugëve me zhavor në fshatrat e Komunës së Prishtinës", me numër të prokurimit 616-22-11624-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – "Kuvendi i Komunës së Prishtinës", kjo ankesë nuk mund të shqyrtohet, pasi që e Operatori ekonomik konsiderohet si palë pa interes juridik material konform nenit 4 paragrafi 1.26 të LPP-së.

I lejohet, autoritetit kontraktues – "Kuvendi i Komunës së Prishtinës" që të vazhdoj më tutje me aktivitetin e prokurimit "Trajtimi i rrugëve me zhavor në fshatrat e Komunës së Prishtinës", me numër të prokurimit 616-22-11624-5-1-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

-Faktet dhe rrethanat procedurale-

Me datë 21.10.2022, "Kuvendi i Komunës së Prishtinës", ka publikuar B05-Njoftimin për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Trajtimi i rrugëve me zhavor në fshatrat e Komunës së Prishtinës", me numër të prokurimit 616-22-11624-5-1-1.

Me 17.11.2023 AK ka publikuar njoftimin B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, ku sipas këtij njoftimi OE N.Sh.T "Viktory Com & Marisa Sh.P.K & Company Murseli Shpk" Sh.P.K, është rekomanduar për dhënie të kësaj kontrate.

OE "Milenium Konstruktion Sh.P.K" me datën 21.11.2023 kishte parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të AK të datës 17.11.2023, ndërsa AK me datën 23.11.2023, ka hedhur poshtë si të pa lejuar kërkesën për rishqyrtim të OE ankues.

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 04.12.2023 ka pranuar ankesën me Nr. protokollit 969/23 nga operatori ekonomik "Milenium Konstruktion Sh.P.K", lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Trajtimi i rrugëve me zhavor në fshatrat e Komunës së Prishtinës", me numër të prokurimit 616-22-11624-5-1-1, iniciuar nga "Kuvendi i Komunës së Prishtinës", në cilësinë e Autoritetit Kontraktues.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Nga provat e prezantuara, për aktivitetin e prokurimit "Trajtimi i rrugëve me zhavor në fshatrat e Komunës së Prishtinës" me numër të prokurimit 616-22-11624-5-1-1, iniciuar nga "Kuvendi i Komunës së Prishtinës", konstatohet se njoftimi për kontratë është publikuar në sistemin e-prokurimi me datë 21.10.2022. Operatori ekonomik me të dhënat e cekura si më lartë, me datën 04.12.2023, si pale e pakënaqur me vendimin e AK-së së datës 17.11.2023, ka parashtruar ankesë në OSHP (Protokoll 969/23).

Organi Shqyrtues i Prokurimit, pas shqyrtimit dhe realizimit të të gjitha provave dhe shkresave të lëndës, konstaton se për këtë procedurë të prokurimit OE "Milenium Konstruktion Sh.P.K", ka parashtruar edhe më parë ankesë në OSHP, me numër të protokollit 2023/0620, për të cilin OSHP me datën 03.11.2023, ka publikuar vendimin 2023/0620, me të cilin OE ankues është cilësuar si i pa përgjegjshëm lidhur me aktivitetin e prokurimit andaj edhe është eliminuar nga pjesëmarrja.

OSHP pas shqyrtimit dhe analizimit të gjithë dokumentacionit të ankesës dhe procedurës së prokurimit në kontekstin shpjegimeve si me sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, palëve në procedurë u konstatua se

ankuesi cilësohet si palë pa interes juridik material, ku nder të tjera vihet në zbatim neni 103 i LPP, sipas të cilit, "Dispozitat e kësaj pjese përcaktojnë të drejtat themelore dhe procedurale dhe mjetet juridike në dispozicion të palëve të interesuara siç është përkufizuar ky term ("palë e interesuar") në nenin 4 (të këtij ligji)". Kuptimi i kësaj dispozite vërteton fare qartë mendimin e OSHP se, mjetet juridike mund të vihen në lëvizje vetëm nga palët e interesuara duke ju referuar në këtë rast pikërisht përkufizimit të dhënë në nenin 4 të LPP.

Prandaj bazuar në kuptimin e nenit 4, të LPP, lidhur me nenin 103 dhe 111, të këtij Ligji, Paneli shqyrtues konsideron se parashtuesi i saj nuk mund të konsiderohet palë e interesuar dhe se nuk ka nevojë të lëshohet në vlerësimin meritore të pohimeve specifike të kësaj Ankese, sepse të njëjtat janë jo lëndore në kuptim të nenit 111 të LPP dhe për këtë çështje juridike janë dhënë dy vendime me Nr.2023/061 me datën 02.05.2023, dhe 2023/0620 me datën 03.11.2023, me të cilin vendim ka kthyer aktivitetin e prokurimit në fjalë në rivlerësim ndërsa OE "Milenium Konstruktion Sh.P.K" është vlerësuar si i papërgjegjshëm andaj edhe është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit. Cituar shkurtimisht si vijon: Lidhur me arsyen e eliminimit të OE ankues "Milenium Konstruktion Sh.P.K" nga ky aktivitet, Paneli Shqyrtues konstaton se Autoriteti Kontraktues me vendimin paraprak të referuar si më sipër ka vepruar konform udhëzimeve të dhëna, ku është evidentuar fakti që oferta e OE të rekomanduar ka përmbajtur çmime jo të tregut sipas ekspertit shqyrtues të cilit i ju kishte falur besimi, ndërsa tanimë i njëjti ka statusin e ankuesit i cili është eliminuar nga ky aktivitet prokurimi, andaj duke konsideruar se rrethanat e zhvilluara ku AK-ka ka kërkuar sqarime shtesë edhe nga ankuesi por nuk është bindur me çmimet e ofruara, duke e refuzuar kështu ofertën e OE si ofertë me çmim jo 9 normalisht të ulët, e po ashtu duke konsideruar se edhe eksperti shqyrtues ka rekomanduar se ky pretendim lidhur me çmimin e ofertuar të trajtohet si i pabazuar, paneli shqyrtues ka arritur në vendim-marrjen që çmimi i ofertuar në lidhje me 10€ për metër kub të betonit është çmim jo normalisht i ulët në krahasim me çmimet e tregut si dhe në këtë pikë pajtohet me raportin e ekspertit, për të arritur në këtë vendim-marrje po ashtu është konsideruar se pohimet ankimore të OE ankues nuk kanë përmbajtur argumente, fakte, të gjetura si dhe dëshmi konkrete në relacion me çmimet e ofertuara ashtu siç përcaktohet me nenin 61 të LPP-së, në mënyrë që nga ana e panelit ky pretendim të klasifikohet si i bazuar, megjithatë duhet theksuar se legjislacioni në fuqi i referohet AK-së si përgjegjës dhe i jep ushtrimin e diskrecionit që të bindet me ofertat dhe çmimet jo-të tregut andaj edhe sqarimet e dhëna nga OE ankues kanë qenë jo-bindëse për AK-në, kështu që rrjedhimisht duke u bazuar nga të gjitha që u thanë si më sipër, OE ankues nga ana e panelit klasifikohet si i papërgjegjshëm lidhur me këtë aktivitet prokurimi andaj eliminohet nga pjesëmarrja në të. Pas vlerësimit dhe administrimit të të gjitha provave përkitazi me këtë procedurë të prokurimit, OSHP konsideron se ankesa e OE ankues e pranuar në OSHP me datën 04.12.2023 është e palejuar sepse e njëjta është çështje e gjykuar "Res Judicata" më parë dhe për të njëjtin tashmë është marrë vendim.

Nga të gjitha sqarimet e cekura si më lartë, OSHP e hedhë si të pa lejuar ankesën e parashtuar me datën 14.12.2023 me nr. protokollit 969/23 nga operatori ekonomik "Milenium Konstruktion Sh.P.K", sepse ankesa për këtë procedurë të prokurimit, konsiderohet çështje e gjykuar sipas

paragrafit 2.16 të nenit 105 të Ligjit për Prokurim Publik, ku thuhet: “Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar “res judicata”, dhe konform nenit 4, 1. 26 të ligjit, OE ankues “Milenium Konstruktion Sh.P.K”. me emrin tregtar konsiderohet si palë pa interes juridik për shkak se me vendimin 620/23, i njëjti është konsideruar si i papërgjegjshëm, prandaj Ankuesi nuk mund të arrijë të dëshmojë se ka statusin e palës së interesuar sipas dispozitës 4, 1.26 të LPP-së.

Autoriteti kontraktues – “Kuvendi i Komunës së Prishtinës” mund të vazhdoj më tutje me aktivitetin e prokurimit (e përshkruar me sipër) nëse nuk ka ankesë tjetër për këtë aktivitet. Organi Shqyrtues i Prokurimit i vë në dijeni se në çdo aktivitet AK duhet të veproj konform dispozitave dhe autorizimeve ligjore siç përcaktohen ato me nenin 1, 6, 7, 27, 28, 59, 60, 65 të LPP. ndërsa, konform nenit 24.2 të LPP sa i përket operatorit ekonomik të rekomanduar për kontrat mbetet në përgjegjësi të AK .

Kryetari i PSH-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetari i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur ka të drejtë që t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë në afat prej 30 ditësh, nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK-Komuna e Prishtinës
- OE ankues
- Arkivës së OSHP-së;
- Për publikim në ueb-faqe zyrtare;